



# Ndërmarrja Publike Lokale **KASTRIOTI** Sh.A

Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq  
Tel: +383 46666607; +383 48777624  
Email: nplkastrioti@gmail.com; web: www.nplkastrioti.com



Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A  
Lokalno Javno Produzeće "Kastrioti" D.D  
Local Public Enterprise "Kastrioti" J.S.C

Obiliq

Datim:

Date:

Nr. I Prot:

Br. Prot:

Prot. No:

27.01.2025 I-119/25

Në bazë të nenit 8.1 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 si dhe bazuar në Udhëzimit Administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik NR.01/2024 të nenit 4.1, 5.1 dhe 5.2, në Statutin e Ndërmarrjes me nr prot 1888/24 të nenit 36 paragrafi 36.3 si dhe vendimit me nr protokoll I-113/25 datës 23.01.2025 Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A Obiliq me datën 27.01.2025 shpallë:

## KONKURS PUBLIK

**Pozita: KUZHINIER/E**

**Numri i punëtorëve: 2**

**Përgatitja shkollore:** Diploma e shkollës së mesme

**Përvoja e punës:** 1 vit

**Kushtet e veçanta:** Kualifikimet e nevojshme për kuzhinier

**Orari i punës:** i plotë

**Puna provuese:** 6 muaj

**Vendi:** Obiliq

**Shkathësitë kyçe, njohuri, aftësitë e nevojshme:**

- Njohja e punës në gastronomi
- Të ketë aftësi të theksuar organizative

**Punët dhe detyrat e punës:**

- Përkujdeset për përgatitjen e ushqimit në Kuzhinën;
- Kujdeset që kuzhina dhe të gjitha pajisjet e kuzhinës, gjatë përgatitjes dhe shërbimit të ushqimit, të përdoren në mënyrë korrekte dhe të jenë në gjendje funksionale dhe të gatshme për përdorim;
- Kujdeset dhe siguron që zonat e gatimit të ushqimit në kuzhinë të jenë në gjendje të pastër enët e kuzhinës, ushqimi, pemët dhe perimet të lahen mirë;
- Kujdeset që të përdoren metodat e duhura të gatimit të ushqimit, duke siguruar që proteinat dhe vitaminat e ushqimit të mos humbin për shkak të zierjes së gjatë;
- Numërimi i shujtave dhe klasifikimi i tyre në bazë të numrit të fëmijëve;
- Të kryej edhe detyra të tjera të caktuara nga rregullorja e institucionit apo udhëheqësi;
- Për kryerjen e detyrave i përgjigjet Eprorit të tij/saj.

**Procedurat e Konkurrimit: Kandidati-ja për këto pozita duhet t'i dorëzojnë këto dëshmi:**

- Dëshminë e kualifikimit,
- Dëshminë mbi përvojën e punës
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Certifikatën nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj),
- Aplikacionin për punësim, i cili merret në faqen e NPL "Kastrioti" Sh.A. (i nënshkruar).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes e-mailit zyrtar: [konkursetnplkastrioti@gmail.com](mailto:konkursetnplkastrioti@gmail.com)

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë vendbanimin, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për testin me shkrim.

Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

- **Konkursi është i hapur 15 ditë nga data e publikimit.**

